



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:070859
Datë: 24.09.2024
Numri i dokumentit: 06200705

C-IV-13-3264

Ankuesi

R R fshati R, Hani i Elezit

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP (NSH "Agromorava" në likuidim), Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakërishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), gjyqtarja Ganimete Puka, me 24.shtator. 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Secila palë i bartë shpenzimet veta procedurale.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 22. Nëntor. 2013, pranë DHPGJSK, ankuesi parashtroj ankesë, për rishikim të vendimit të AL, me të cilën kërkon dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 2.030.00€, me të cilën AKP ai ka pranuar vetëm shumën prej 1.408.12 €.

Më 20.prill.2017, AKP, në mbrojtje e ka kundërshtuar në tersi kërkesën e ankuesit duke kërkuar që ankesa të refuzohet si e pa pranueshme dhe të vërtetohet vendimi i AL, për arsyet e theksuara sikur në këtë mbrojtje.

Më 11.maj.2017, ankuesi , në përgjigje ndaj mbrojtës, ka mbete pranë ankesës, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të ndryshohet vendimi i AL.

Më 26.maj.2017, AKP, në kundërpërgjigje mbetet në tersi pra mbrojtës dhe propozimit për refuzim të ankesës si e pa bazuar.

Më 27.korrik.2023, ankuesi duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës ka dorëzuar si provë librezën e punës.

Më 14. Gusht.2024, gjykata lëshoj një urdhër për ankuesin më vërejtje për pagesën e taksës gjyqësore, si dhe të dorëzoj si provë aktgjykimin C.nr.111/11 në mbështetje të ankesës së tij. Me të njëjtën vërejtje ankuesi u informua se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Urdhrin , e lartë cekur, i është dorëzuar ankuesit me 19.gusht. 2024, dhe gjer me datën e lëshimit të këtij vendimi taksat gjyqësore nuk janë paguar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 për DHPGJS (Ligji nr. 06/L-086) parasheh: *Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Ankuesja komfor dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh: *Në qoftë se paditësi/ja nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.*

Me 14.gusht. 2024, gjykata përmes vërejtjes kërkoj nga ankuesi, që të bëj pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar së ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankuesi i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëj pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Ankuesi ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të DHPGJS-së në lidhje me udhëzimin e KGJK-së Nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Nga kjo gjykata konsideron se ankuesi nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

Gjykata nga gjitha arsyet e lartcekura nuk ndërmori veprime të mëtutjeshme procedurale si dhe nuk hyri në shqyrtim të çështjes.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Ganimete Puka,

G j y q t a r e